




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-4348/12</u>
Dep.	Prot. No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>05.12.2012</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **26.11.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2428/12, për ztr. *Artan Nimani* – Drejtor në Bordin e Kompanisë Regjionale të ujit, KRU” Radoniqi&Dukagjini” – Gjakovë, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2428-12, pas zhvillimit të procedurës, është konstatuar se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2428-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Artan Nimani – Drejtor në Bordin e Kompanisë Regjionale të ujit, KRU ”Radoniqi&Dukagjini” në Gjakovë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit,

konsiderohet papajtushmëri funksionesh (Neni 15 , pika 1), zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Nimani është paraqitur ne takim me zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Nimani, ka deklaruar se, menjëherë ka filluar procedurat për parandalimin e konfliktit të interesit.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, ztr.Nimani, me datën 09.11.2012, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellur dokumentin zyrtar nga ARBK-ja (DPK.DPKI-03-4096/12), me informacionet e reja mbi biznesin; "Trend Group"L.L.C., në të cilat shihet se ai, tashmë, ka hequr dorë nga funksioni i tij menaxhues në këtë biznes.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

